TrafikuUrban
PRISHTINË

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE
"TRAFIKU URBAN" SH.A.
PRISHTINË
Nr. 3348 dt. 30.10.2026

N.P.K. „TRAFIKU URBAN" SH.A. PRISHTINË

Plani i Biznesit 2027



TETOR, 2026

Përmbajtja

1. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv 4
2. Përmbledhje ekzekutive 5
2.1 Viti 2027 në shifra 5
3. Profili i ndërmarrjes 6
3.1 Të dhënat e regjistrimit 6
3.2 Veprimtaritë e ndërmarrjes 6
4. Vizioni, Misioni dhe Vlerat 7
4.1 Vlerat tona 7
5. Objektivat strategjike për vitin 2027 8
5.1 Zgjerimi i flotës dhe i mbulimit të rrjetit 8
5.2 Rritja e numrit të udhëtarëve 8
5.3 Digjitalizimi i biletimit dhe i informimit 9
5.4 Kalimi drejt transportit të gjelbër 9
5.5 Qëndrueshmëria financiare 9
5.6 Cilësia dhe besueshmëria e shërbimit 9
5.7 Zhvillimi i stafit dhe kushtet e punës 9
5.8 Bashkëpunimi institucional 9
6. Plani operativ sipas fushave 10
6.1 Transporti 10
6.2 Mirëmbajtja 10
6.2.1 Mirëmbajtja si burim i të hyrave 11
6.2.2 Investimet për përmirësimin e kushteve të punës 11
6.2.3 Autoparku dhe pamja e objektit 11
6.2.4 Shërbimet mbështetëse dhe autolarja automatike 12
6.3 Administrata, burimet njerëzore, çështjet ligjore dhe IT 13
Burimet njerëzore dhe trajnimet 13
Zyra ligjore 13
Teknologjia informative 13
6.4 Marketingu dhe shërbimi ndaj udhëtarëve 14
Marketingu komercial 14
Aplikacioni mobil 14
Biletat dhe çmimet 15
7. Plani financiar për vitin 2027 16
7.1 Struktura e shpenzimeve operative 17

8. Investimet kapitale 18
9. Menaxhimi i rreziqeve 19
10. Analiza SWOT 20
11. Bashkëpunimi me palët e treta 20
12. Përfundim 21
Aneksi 1 22
Aneksi 2. Buxheti i detajuar për vitin 2027 31

1. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv

Të nderuar partnerë, përfaqësues institucionalë dhe qytetarë,

Që nga themelimi në vitin 1976, Ndërmarrja Publike Komunale „Trafiku Urban" Sh.A. ka pasur një mision të qartë: t'u ofrojë qytetarëve të Prishtinës transport publik të sigurt, të besueshëm dhe të qasshëm. Sot, si shoqëri aksionare në pronësi të Komunës së Prishtinës, këtë mision e vazhdojmë me standarde të reja, për një kryeqytet që rritet dhe ndryshon çdo ditë.

Viti 2027 shënon një moment kthese për ndërmarrjen. Me 30 autobusë elektrik që hyjnë në qarkullim nga muaji prill, flota rritet nga 51 në **81 autobusë**. Kjo na mundëson të mbulojmë mbi gjysmën e linjave të transportit publik në Prishtinë, me shërbim më të shpeshtë, më të rregullt dhe më të rehatshëm për qytetarët.

Plani parasheh gjithashtu avancimin e biletimit elektronik përmes kuletës digjitale, digjitalizimin e menaxhimit të flotës dhe informimin e udhëtarëve në kohë reale. Autobusët elektrikë janë hapi ynë i parë konkret drejt një Prishtine me ajër më të pastër.

Marrëveshja për Shërbime Publike (PSC) mbetet burimi kryesor dhe i qëndrueshëm i të ardhurave tona. Përmes menaxhimit të kujdesshëm financiar, do t'i përmbushim me rregull detyrimet ndaj kredisë së BERZH-it dhe do të ruajmë stabilitetin dhe transparencën në operim.

Në qendër të këtij plani janë edhe njerëzit tanë. Do të përmirësojmë kushtet e punës, do të investojmë në trajnime të vazhdueshme dhe, në përputhje me mundësitë financiare, do të shqyrtojmë përmirësimin e kompensimit të punonjësve.

Jam mirënjohës të gjithë partnerëve institucionalë, në veçanti Komunës së Prishtinës, për mbështetjen e vazhdueshme. Ky plan është rezultat i punës së përbashkët dhe i një përkushtimi të qartë: një transport publik modern, i qëndrueshëm dhe në shërbim të qytetarit.

Me respekt,

Qendrim Vitija
U.D. Kryeshef Ekzekutiv
N.P.K. „Trafiku Urban" Sh.A.

2. Përmbledhje ekzekutive

Plani i Biznesit 2027 përcakton si do ta mbajë N.P.K. „Trafiku Urban" Sh.A. Prishtinën në lëvizje gjatë një viti zgjerimi të madh. Me 30 autobusë elektrik flota rritet nga 51 në **81 autobusë**. Ndërmarrja synon të mbulojë mbi 50% të linjave të transportit publik dhe të rrisë numrin e udhëtarëve për rreth **25%** krahasuar me vitin 2026.

Prioritetet strategjike janë katër: zgjerimi dhe riorganizimi i rrjetit të linjave në koordinim me Komunën; digjitalizimi i biletave, informimit dhe menaxhimit të flotës; kalimi gradual drejt transportit të gjelbër; dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe kapaciteteve të stafit.

Financiarisht, ndërmarrja planifikon **€15.6 milion** të hyra, nga të cilat 94.6% vijnë nga kontrata PSC. Shpenzimet operative planifikohen në **€14 milion**, me fitim operativ para zhvlerësimit prej **€1.20 milion** dhe fitim neto prej **€17,584.80**.

2.1 Viti 2027 në shifra

51 autobusë aktual	**30** Autobus Elektrik investim i ri	**>50%** e linjave të transportit publik	**+25%** udhëtarë krahasuar me 2026
€15.6 mln të hyra të planifikuara	**€1.6 mln** fitim operativ para zhvlerësimit	**€17,584.80** Fitimi neto	**linja të reja** me 30 autobusët elektrik

Mesazhi kryesor

Viti 2027 është viti kur „Trafiku Urban" kalon nga ruajtja e shërbimit në rritjen e tij: më shumë autobusë, më shumë linja, më shumë udhëtarë dhe një shërbim më digjital e më i pastër, mbi një bazë financiare të qëndrueshme.



Autobusët e „Trafikut Urban" në qarkullim në Prishtinë

3. Profili i ndërmarrjes

N.P.K. „Trafiku Urban" Sh.A. kryen transportin e udhëtarëve në linjat urbane dhe urbane-periferike të Prishtinës dhe bën pjesë në veprimtaritë shërbyese komunale. Komuna e Prishtinës e organizoi këtë shërbim më 1 prill 1976, kur ndërmarrja u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale.

3.1 Të dhënat e regjistrimit

Elementi	Të dhënat
Emri i biznesit	N.P.K. „TRAFIKU URBAN" SH.A.
Lloji i biznesit	Shoqëri Aksionare, në pronësi të Komunës së Prishtinës
Adresa	Rr. Tahir Zajmi nr. 43, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Lokacioni	Në jugperëndim të qendrës së Prishtinës
Viti i themelimit	1976
Burimi kryesor i të hyrave	Marrëveshja për Shërbime Publike (PSC), pagesë për kilometër të kaluar

3.2 Veprimtaritë e ndërmarrjes

Kategoria	Veprimtaria
Kryesore	Transporti rrugor urban dhe ndërurban i pasagjerëve
Dytësore	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.
Të tjera	Aktivitetet shërbyese të rastit për transport tokësor
	Qiradhënia dhe menaxhimi i pronave të patundshme, personale ose të marra me qira
	Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerive, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të luajtshëm
	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve dhe e pajisjeve të tjera të transportit
	Tregtia e automjeteve të tjera
	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe e produkteve të lidhura me to

4. Vizioni, Misioni dhe Vlerat

VIZIONI

Kryeqyteti lëviz me ne.

Një kryeqytet ku transporti publik është zgjedhja e parë e çdo qytetari: të jemi shtylla e transportit publik të kryeqytetit që: lidhim lagjet, njerëzit dhe mundësitë e qytetit. Me një flotë moderne, shërbime digjitale dhe një staf të përkushtuar, që ofrojmë çdo ditë udhëtime të sigurta, të rregullta dhe të përballueshme për të gjithë.

MISIONI

Ta mbajmë Kryeqytetin në lëvizje.

Çdo ditë i lidhim qytetarët e Kryeqytetit me punën, shkollën dhe shërbimet, me udhëtime të sigurta, të rregullta dhe të përballueshme për të gjithë, përmes një flote moderne, shërbimeve digjitale të thjeshta dhe një stafi të përkushtuar.





„Kryeqyteti lëviz me ne, sepse ne e mbajmë Kryeqytetin në lëvizje"

4.1 Vlerat tona

Vlera	Çfarë do të thotë në praktikë
Siguria	Sigurinë e udhëtarëve dhe e stafit prioritet.
Përpikëria	Autobusi vjen kur e kemi premtuar (me orar).
Qasja për të gjithë	Shërbim i barabartë për çdo qytetar, përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
Përgjegjësia	Përdorim i kujdesshëm dhe transparent i fondeve.
Respekti për mjedisin	Më pak makina në rrugë, ajër më i pastër për qytetin.

5. Objektivat strategjike për vitin 2027

Objektivat e vitit 2027 rrjedhin drejtpërdrejt nga misioni dhe secili ka një tregues të matshëm, një përgjegjës dhe një afat. Kështu bordi dhe Komuna mund ta ndjekin realizimin e planit gjatë gjithë vitit.

Nr.	Objektivi	Treguesi dhe caku 2027	Përgjegjës
5.1	Zgjerimi i flotës dhe i mbulimit të rrjetit	Flota: 81 autobusë; mbi 50% e linjave të transportit publik	Aksionarët dhe Bordi
5.2	Rritja e numrit të udhëtarëve	+25% udhëtarë krahasuar me 2026	Transporti, Marketingu
5.3	Digjitalizimi dhe modernizimi i shërbimeve	GPS dhe informim në kohë reale në të gjitha linjat; Implementimi i sistemit te biletave elektronike	IT, Marketingu
5.4	Zhvillimi i transportit të gjelbër	Panele solare në objektin e ndërmarrjes	Menaxhmenti
5.5	Qëndrueshmëria financiare	Të hyra €15.6 mln; fitim neto ≥ €17,584; 100% e kësteve të kredisë në afat	Financat
5.6	Cilësia dhe besueshmëria e shërbimit	Përpikëria ≥98%; gatishmëria e flotës ≥98%; anketë vjetore e kënaqshmërisë	Transporti, Mirëmbajtja
5.7	Zhvillimi i stafit dhe kushtet e punës	Plan vjetor trajnimesh; çdo punonjës në ≥1 trajnim; 4 projekte për kushtet e punës	Burimet Njerëzore
5.8	Bashkëpunimi institucional	Plan i përbashkët me Komunën për linjat; vendime për korsi të dedikuara për autobusë	Menaxhmenti

5.1 Zgjerimi i flotës dhe i mbulimit të rrjetit

Të vihen në operim 30 autobusë elektrik dhe të mbulohen mbi 50% e linjave të transportit publik sipas Planit të Mobilitetit dhe rrjetit të ri të linjave.

- Pranimi teknik, regjistrimi dhe futja në qarkullim e 30 autobusë elektrik nga prilli 2027.
- Rishpërndarja e flotës sipas ngarkesës së linjave dhe rritja e frekuencës në orët e pikut.
- Koordinimi i orareve me operatorët privatë për një rrjet të integruar.

5.2 Rritja e numrit të udhëtarëve

Transporti publik të bëhet zgjedhja e parë e qytetarëve, me rritje 25% të udhëtarëve krahasuar me 2026.

- Fushata informuese për linjat, oraret dhe çmimet e reja të biletave.
- Promovimi i biletave mujore, vjetore dhe korporative për punëtorë.
- Matja periodike e numrit të udhëtarëve sipas linjave dhe orareve.

5.3 Digjitalizimi i biletimit dhe i informimit

Udhëtimi të jetë i thjeshtë nga telefoni: biletë digjitale, vendndodhja e autobusit në kohë reale dhe informim i saktë.

- Avancimi i kuletës digjitale dhe i biletave me SMS, me çmim më të ulët se bileta fizike.
- GPS për autobusët e ndërmarrjes dhe të operatorëve privatë, si dhe aplikacioni mobil për të gjitha linjat.
- Panele informuese, ekrane LCD në autobusë dhe harta digjitale të linjave.

5.4 Kalimi drejt transportit të gjelbër

Uljen e emetimeve dhe të kostos së energjisë e nisim me autobusët e parë elektrikë dhe energjinë diellore.

- Instalimi i paneleve solare në objektin e ndërmarrjes (investim €100,000).
- Autolarje automatike që kursen ujë dhe energji.

5.5 Qëndrueshmëria financiare

Ruajtja e likuiditetit dhe shlyerja pa vonesë e detyrimeve, ndërsa rriten të hyrat vetanake.

- Menaxhimi i kontratës PSC dhe realizimi i kilometrave të planifikuara për të fituar edhe bonusin e performancës.
- Realizimi i €529,200 të hyrave nga marketingu dhe zhvillimi i shërbimeve për palë të treta.
- Monitorim mujor i buxhetit, i çmimit të naftës dhe i normës EURIBOR.

5.6 Cilësia dhe besueshmëria e shërbimit

Autobusi të vijë në kohë, të jetë i pastër, i sigurt dhe i rehatshëm.

- Mirëmbajtje parandaluese dhe menaxhim i pjesëve rezervë për të ulur ndërprerjet në linjë.
- Monitorim i përpikërisë përmes GPS-it dhe raporte mujore sipas linjave.
- Anketë vjetore e kënaqshmërisë së udhëtarëve (buxhet €5,000) dhe plan veprimi pas saj.

5.7 Zhvillimi i stafit dhe kushtet e punës

Staf i aftë, i motivuar dhe i sigurt në punë.

- Plan vjetor trajnimesh teknike, profesionale dhe menaxheriale, i hartuar me drejtorët e njësive.
- Rikonstruktimi i kanaleve të punës, gomisteria, dhoma e riparimeve gjenerale dhe rrjeti pneumatik.
- Kontrolle sistematike mjekësore dhe sigurim shëndetësor për punonjësit.

5.8 Bashkëpunimi institucional

Planifikim i përbashkët me Komunën e Prishtinës për një transport publik më të shpejtë dhe më të integruar.

- Propozime të përbashkëta për korsi të dedikuara dhe përparësi në qarkullim për autobusët.
- Koordinim i politikave të transportit dhe i projekteve të mobilitetit.
- Raportim i rregullt tek aksionarët për realizimin e PSC-së dhe të këtij plani.

6. Plani operativ sipas fushave

6.1 Transporti

Transporti planifikon, organizon dhe realizon shërbimin në linjat e përcaktuara për Trafikun Urban. Në vitin 2027 prioritet është realizimi i plotë i kilometrave sipas kontratës PSC, orare të rregullta, shfrytëzim racional i flotës dhe monitorim i vazhdueshëm i performancës.

Plani vjetor i operimit është hartuar sipas vendimeve të Komunës dhe detyrimeve të kontratës PSC. Ai përfshin itineraret, oraret dhe kilometrat e planifikuara për çdo linjë. Oraret e plota janë në **Aneksin 1**.

Linja	Itinerari (dhe anasjelltas)	Autobusë	Orari i operimit
1	Prishtinë – Fushë Kosovë	9	06:00 – 24:00
1A	Prishtinë – Aeroport	1	07:00 – 24:00
3	Rrethi i Matit – Bardhosh	11 (inkorporohen autobus të linjës 3B)	06:00 – 24:00
3B	Rrethi i Matit – Bërnicë e Ultë	2	06:10 – 21:30
3C	Bregu i Diellit – Sinidoll	7	06:00 – 22:00
4	Lagja Mati – Parku i Gërmisë	17	06:00 – 24:00
7C	Kalabri – Qendër	4	06:00 – 22:00
15	Prishtinë – Prapashticë	1	07:00 – 19:00
19	Prishtinë – Kishnicë	1 (inkorporohen autobus të linjës 7C)	07:00 – 19:00
Sipas vendimet të Komunës		30	06:00 – 24:00

Tabela 1. Linjat e operuara nga „Trafiku Urban" dhe numri i autobusëve në operim ditor

6.2 Mirëmbajtja

Plani i mirëmbajtjes synon gatishmëri maksimale të flotës dhe sa më pak kohë jashtë qarkullimit, me kosto të kontrolluar. Në vitin 2027 fokusi është te:

- **Mirëmbajtja parandaluese:** kontrolle periodike dhe identifikim me kohë i defekteve.
- **Siguria teknike:** çdo autobus në qarkullim të jetë teknikisht i rregullt.
- **Pjesët rezervë:** stoqe të planifikuara për riparime në kohë dhe më pak ndërprerje.
- **Evidenca:** regjistër digjital i defekteve, riparimeve dhe historikut të çdo autobusi.
- **Kostoja dhe efikasiteti:** analiza e kostos për autobus dhe për kilometër.

6.2.1 Mirëmbajtja si burim i të hyrave

Sektori i Mirëmbajtjes do ta zgjerojë gamën e shërbimeve dhe do të fillojë t'u shërbejë palëve të treta. Kështu ulen shpenzimet e jashtme dhe krijohen të hyra të reja. Për këtë planifikohen investimet në vijim:

- Makinë për riparimin e injektorëve të naftës
- Makinë për riparimin e turbinave
- Makinë për rrafshimin e kokës së motorit
- Makinë për pastrimin e pjesëve të karbonizuara
- Makinë për pastrimin e filtrave të grimcave (DPF)
- Frezë NC
- Autolarje automatike për autobusë dhe kamionë



Figura 1. Shërbimet e reja për palë të treta

6.2.2 Investimet për përmirësimin e kushteve të punës

Investimet kapitale për kushtet e punës përfshijnë:

- Rikonstruktimin e kanaleve të punës;
- Funksionalizimin e gomisterisë me pajisje për montim dhe balancim të gomave;
- Ndërtimin e dhomës së riparimeve gjenerale të motorëve dhe ndërruesve;
- Shtrirjen e rrjetit pneumatik në hapësirat e punës.

Këto investime e shfrytëzojnë më mirë stafin ekzistues, rrisin efikasitetin dhe e bëjnë Sektorin e Mirëmbajtjes një hallkë kyçe të zhvillimit të ndërmarrjes.

6.2.3 Autoparku dhe pamja e objektit

Me rritjen e flotës në 81 autobusë, ridizajnimi i autoparkut sipas standardeve bëhet domosdoshmëri për sigurinë dhe për lëvizjen e rregullt të autobusëve brenda objektit. Paralelisht, rinovimi i kioskës në hyrje do ta përmirësojë pamjen e ndërmarrjes dhe shërbimin ndaj qytetarëve.



Figura 2. Organizimi i propozuar i autoparkut



Figura 3. Pamja e propozuar e hapësirës së jashtme dhe e kioskës

6.2.4 Shërbimet mbështetëse dhe autolarja automatike

Shërbimet Mbështetëse kujdesen për pastrimin e autobusëve, mirëmbajtjen e ambienteve dhe logjistikën. Blerja e një sistemi automatik për larjen e jashtme të autobusëve do ta shkurtojë kohën e larjes, do të kursejë ujë dhe energji, do të përmirësojë kushtet e punëtorëve dhe do të mundësojë shërbime për palë të treta.



Figura 4. Projekti i autolarjes automatike për autobusë

6.3 Administrata, burimet njerëzore, çështjet ligjore dhe IT

Administrata mbështet funksionimin e ndërmarrjes, koordinon njësitë organizative dhe menaxhon burimet njerëzore, juridike dhe teknologjike. Në vitin 2027 fokusi është te procese më të shpejta, ngritja e kapaciteteve, ligjshmëria dhe infrastruktura teknologjike.



Figura 5. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

Burimet njerëzore dhe trajnimet

Ndërmarrja do të organizojë trajnime periodike teknike, profesionale, ndërpersonale dhe menaxheriale, me fokus te cilësia e shërbimit dhe siguria në trafik.

Temat prioritare do të përcaktohen bashkë me drejtorët dhe menaxherët, sipas nevojave të çdo vendi pune.



Foto 1. Trajnim për stafin

Zyra ligjore

Zyra Ligjore ofron mbështetje juridike për organet drejtuese dhe njësitë organizative: mbrojtjen e interesave juridike të ndërmarrjes, trajtimin e kontesteve gjyqësore, këshillimin ligjor dhe harmonizimin e akteve të brendshme me legjislacionin në fuqi. Për konsulencë, përfaqësim, noterizim dhe taksa gjyqësore janë planifikuar €70,750.

Teknologjia informative

- Menaxhimi i infrastrukturës teknologjike përfshin mirëmbajtjen dhe modernizimin e rrjetit kompjuterik, pajisjeve dhe sistemeve të komunikimit, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe parandalim të ndërprerjeve;
- Avancimi i sistemeve digjitale përfshin mirëmbajtjen dhe përmirësimin e platformës;
- General Software TU, përditësimin e ueb-faqes zyrtare dhe zhvillimin e funksionaliteteve që lehtësojnë proceset e punës;
- Mbështetja teknike fokusohet në evidentimin dhe trajtimin e kërkesave, zgjidhjen efikase të problemeve dhe analizimin e ndërhyrjeve për të parandaluar përsëritjen e tyre.



Foto 2. Shërbimet digjitale të ndërmarrjes

Vëmendje e veçantë i kushtohet sigurisë kibernetike dhe planifikimit të investimeve teknologjike, përmes mbrojtjes së sistemeve dhe të dhënave, kontrollit të qasjeve, krijimit të kopjeve rezervë dhe identifikimit të zgjidhjeve të reja në përputhje me nevojat dhe prioritetet e ndërmarrjes.

6.4 Marketingu dhe shërbimi ndaj udhëtarëve

Marketingu synon rritjen e përdorimit të transportit publik, komunikim më të mirë me qytetarët dhe një imazh më të fortë institucional. Aktivitetet kryesore janë:

- Identifikimi i nevojave dhe pritshmërive të udhëtarëve;
- Informimi për linjat, oraret dhe biletat;
- Promovimi i transportit publik si alternativë ekonomike dhe e qëndrueshme;
- Matja e rezultateve dhe e kënaqshmërisë së qytetarëve.

Marketingu komercial

Në përputhje me Rregulloren e Marketingut dhe kontratën në fuqi, ndërmarrja shfrytëzon hapësirat reklamuese në autobusë, përmes brendimit të jashtëm dhe monitorëve reklamues. Nga marketingu planifikohen **€ 529,200** të hyra në vitin 2027.



Foto 3. Brendimi i jashtëm i autobusëve



Foto 4. Monitorët informues dhe reklamues në autobusë

Aplikacioni mobil

Aplikacioni mobil i „Trafikut Urban", i disponueshëm për IOS dhe Android, u tregon qytetarëve vendndodhjen e autobusëve sipas linjave dhe orareve në kohë reale.



Biletat dhe çmimet

Lloji i biletës	Vlefshmëria	Fizike	Digjitale / SMS
Njëdrejtimëshe	Një udhëtim brenda territorit të Prishtinës	€0.80	€0.60
Ditore	Udhëtime pa limit gjatë ditës, në të gjitha linjat	€1.20	€1.00
Javore	Udhëtime pa limit gjatë javës, në të gjitha linjat	€6.00	€5.00
Mujore	Udhëtime pa limit gjatë muajit, në të gjitha linjat	€18.00	€14.50
Linja e Aeroportit	Një udhëtim në linjën 1A	€6.00	€5.00
Vjetore digjitale	Udhëtime pa limit gjatë vitit	–	€150.00
Korporative vjetore	Për bizneset me 20 e më shumë punëtorë	–	€120.00

Tabela 2. Çmimet e biletave të transportit publik.

Pikat e shitjes

Pika e shitjes	Orari i punës
Kioska prapa objektit të Komunës (te „Plepat")	E hënë – e shtunë 07:00–21:00 · E diel 08:00–16:00
Kioska në lagjen „Kodra e Diellit" (te „Banesat e Bardha")	E hënë – e premte 07:00–21:00 · E shtunë 07:00–14:00
Kioska në Bulevardin „Bill Klinton", afër nënkalimit	E hënë – e shtunë 07:00–21:00 · E diel 08:00–16:00

7. Plani financiar për vitin 2027

Ndërmarrja planifikon **€15.6 milionë** të hyra dhe **€14 milionë** shpenzime operative, me fitim operativ para zhvlerësimit prej **€1.60 milionë** dhe fitim neto prej **€17,584.80**. Plani mbështetet në operimin e 81 autobusëve. Detajet e plota të buxhetit sipas zërave janë në **Aneksin 2**.

Përshkrimi	Vlera (€)	Pjesa
Të hyrat nga kontrata PSC	14,812,614.00	94.6%
Të hyrat nga marketingu	529,200.00	2.9%
Të hyrat nga bonusi sipas PSC	191,401.80	1.5%
Të hyrat sipas kontratës „në shtëpi"	87,324.00	0.7%
Të hyra të tjera	30,000.00	0.2%
Totali i të hyrave	**15,650,539.80**	**100%**
Shpenzimet operative dhe kapitalet	(14,492,955.00)	90.9%
Fitimi operativ para zhvlerësimit	**1,614,984.80**	**9.4%**
Shpenzimet e zhvlerësimit	(1,140,000.00)	8.9%
Fitimi neto i parashikuar	**17,584.80**	**0.2%**

Tabela 3. Pasqyra e parashikuar e të ardhurave për vitin 2027 (pjesa si % e të hyrave totale)

7.1 Struktura e shpenzimeve operative

Pagat dhe karburanti përbëjnë 60% të shpenzimeve operative. Prandaj kontrolli i konsumit të naftës dhe produktiviteti i stafit janë dy levat kryesore të qëndrueshmërisë financiare.



Figura 6. Shpenzimet operative 2027 sipas kategorive

8. Investimet kapitale

Investimi më i madh i vitit është flota e re: furnizimi me 30 autobusë elektrikë urbanë përmes leasing-ut, dhe **€ 457,400** investime kapitale nga burimet vetanake, të përqendruara në pajisje teknike dhe kushte pune.

Investimi	Vlera (€)
Makinë për pastrimin e particle filterit	20,000.00
Presë mekanike (3 copë)	2,400.00
Makinë për balancimin e gomave të autobusëve	6,500.00
Kompletimi i dhomës për riparime gjenerale	22,500.00
Makinë për riparimin e turbinave	17,500.00
Pajisje diagnostifikuese OBD	8,000.00
Makinë për rrafshimin e kokës së motorit	15,000.00
Vinç port. për demontimin e ndërrueseve dhe motorit (2 copë)	7,000.00
Vinç për autobusë për kanale *2+1 vinç për automjete 4.5t	28,000.00
Kompresor i ajrit industrial 12bar + shtrirja e rrjetit	20,000.00
Pajisje salduese TIG dhe set i cilindrave se bashku me dizat për saldim dhe prerje	15,000.00
Makinë për riparimin e injektorëve	25,000.00
Frezë	9,000.00
Mbulimi i kanaleve	15,000.00
Pajisje të autolarjes	15,000.00
Makina për autolarje (2 copë)	10,000.00
Makina industriale për larje të autobusëve	150,000.00
Furnizim me vetura	40,000.00
Inventarizim i depos	15,000.00
Inventarizimi dhe suvatimi i hapësirave të auto ngjyrosjes, dhomës se mekanikeve dhe klimatizimi	4,500.00
Inventar	12,000.00
Totali i investimeve kapitale	**457,400.00**

Tabela 4. Investimet kapitale nga burimet vetanake, renditur sipas vlerës

Investim i kushtëzuar

Në rast të sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare, planifikohet realizimi i investimeve të mëposhtme, të cilat synojnë modernizimin e flotës, rritjen e efikasitetit energjetik dhe përmirësimin e infrastrukturës teknike të ndërmarrjes. Investimet e planifikuara janë:

- Investimi në panele solare për prodhimin e energjisë elektrike, 100,000 €
- Trafo elektrike me pajisjet përcjellëse, 100,000 €

Realizimi i këtyre investimeve do të bëhet vetëm pas konfirmimit dhe sigurimit të burimit të financimit, duke marrë parasysh mundësitë buxhetore të ndërmarrjes, mbështetjen e mundshme institucionale dhe burimet e tjera të financimit.

9. Menaxhimi i rreziqeve

Ndërmarrja ka identifikuar tre rreziqet kryesore për vitin 2027. Për secilin janë caktuar masat dhe njësia përgjegjëse; rreziqet monitorohen gjatë gjithë vitit dhe raportohen te bordi çdo tremujor.

Nr	Fusha e rrezikut	Objektivi	Përshkrimi i rrezikut	Ndikimi në ndërmarrje	Niveli	Masat parandaluese /menaxhuese	Afati	Personi / njësia përgjegjëse	Statusi
1.	Operativ / financiar	Kontrolli i kostove të operimit	Rritja e mundshme e çmimit të naftës dhe luhatjet e tregut	Shton shpenzimet operative, rëndon buxhetin dhe kufizon investimet	I LARTË	Monitorim i çmimeve; planifikim i furnizimeve; optimizim i konsumit	Gjatë vitit 2027	Menaxhmenti / Financa / Operativa	Në proces
2.	Operativ / teknik	Ruajtja e funksionalitetit të flotës	Vjetërsimi dhe përdorimi i autobusëve mund të rrisin kostot e riparimit dhe pjesëve rezervë.	Rrit kostot e mirëmbajtjes dhe rrezikun e ndërprerjeve të shërbimit.	I MESËM	Kontrolle të rregullta teknike; mirëmbajtje parandaluese; menaxhim i pjesëve rezervë.	Gjatë vitit 2027	Mirëmbajtja / Operativa	Në proces
3.	Financiar	Përmbushja e obligimeve kreditore	Rritja e EURIBOR-it mund të rrisë shumën e kështit te kredisë për autobusë nga kredia e BERZH	Rrit këstet dhe shpenzimet financiare; mund të cenojë likuiditetin	I ULËT	Monitorim i EURIBOR-it; planifikim i rrjedhës së parasë; rezerva dhe skenarë buxhetorë.	Gjatë vitit 2027	Financa / Menaxhmenti	Në proces

Tabela 5. Identifikimi i rreziqeve për vitin 2027

Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë kontroll më të mirë të shpenzimeve, përdorim racional të burimeve dhe vazhdimësi të shërbimit. Bashkëpunimi me Komunën është vendimtar për rreziqet që dalin jashtë kontrollit të ndërmarrjes.

10. Analiza SWOT

Analiza SWOT tregon se ndërmarrja hyn në vitin 2027 me një bazë të fortë financiare dhe teknike, por me varësi të lartë nga kushtet e trafikut dhe nga pagesat e PSC-së. Objektivat e **kapitullit 5** janë ndërtuar për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të zbutur këto dobësi.

S • Përparësitë

Kontrata PSC – bazë e qëndrueshme financiare për funksionimin e ndërmarrjes

Tarifa të përballueshme – transport publik me çmime të arsyeshme për qytetarët

Përvoja teknike – stafi i mirëmbajtjes ul varësin nga shërbimet e jashtme

Përvojë 50-vjeçare – njohje e thellë e rrjetit dhe e nevojave të qytetit

W • Dobësitë

Amortizimi i flotës ekzistuese – përdorimi intensiv rrit shpenzimet për riparime

Kapacitete të kufizuara rezervë – mungesa e autobusëve rezervë gjatë defekteve

Varësi nga një burim të hyrash – 94.6% e të hyrave vijnë nga PSC-ja

O • Mundësitë

Autobusët e rinj – modernizim i flotës, kapacitet më i madh dhe shërbim më cilësor

Biletimi elektronik – blerje më e lehtë, kursim kohe dhe kontroll më i mirë i të hyrave

Shërbime për palë të treta – të hyra shtesë nga riparimet dhe autolarja

Autobusët elektrikë – kosto më e ulët energjie dhe imazh i gjelbër

T • Kërcënimet

Kostoja e karburantit dhe e pjesëve – luhatje e çmimeve rrisin shpenzimet operative

Vonesat në pagesat PSC – ndikojnë në likuiditet dhe në planifikimin operativ

Mungesa e korsive të dedikuara – trafiku ul përpikërinë dhe rregullsinë e linjave

Kufizimet infrastrukturore – rrezikojnë treguesit e performancës sipas PSC-së

11. Bashkëpunimi me palët e treta

Marrëveshjet me palët e treta janë mekanizëm i rëndësishëm për zhvillimin e ndërmarrjes. „Trafiku Urban" ka marrëdhënie bashkëpunimi me disa institucione publike dhe ka marrëveshje operative. Në vitin 2027 ndërmarrja synon të zgjerojë kapacitetet përmes pajisjeve që i mundësojnë shërbime mirëmbajtjeje për palë të treta, si dhe përmes autolarjes automatike për autobusë dhe kamionë. Këto iniciativa diversifikojnë të hyrat dhe shfrytëzojnë më mirë kapacitetet ekzistuese, pa e cenuar prioritetin kryesor: transportin publik.

12. Përfundim

Plani i Biznesit për vitin 2027 paraqet orientimin zhvillimor dhe prioritetet kryesore të N.P.K. "Trafiku Urban" Sh.A., me synim avancimin e ndërmarrjes drejt një modeli modern, efikas, financiarisht të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve në Kryeqytet.

Gjatë vitit 2027, ndërmarrja do të fokusohet në:

1. **Modernizimin dhe optimizimin e flotës**, përmes planifikimit të furnizimit me 30 autobusë elektrikë dhe zbatimit të mirëmbajtjes parandaluese të 51 autobusëve ekzistues, me qëllim të rritjes së gatishmërisë dhe efikasitetit operacional.
2. **Përmirësimin e cilësisë së shërbimit**, me theks në përpikëri, higjienë, siguri dhe komoditet për udhëtarët;
3. **Zhvillimin e biletimit digjital** dhe forcimin e mekanizmave për kontrollin e biletave;
4. **Menaxhimin racional të shpenzimeve**, përmirësimin e efikasitetit financiar dhe përmbushjen e detyrimeve kreditore;
5. **Promovimin e transportit të gjelbër** dhe shfrytëzimin më efikas të energjisë.

Realizimi i këtyre objektivave kërkon planifikim të kujdesshëm, koordinim ndërmjet strukturave të ndërmarrjes, shfrytëzim racional të burimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të rezultateve. Për këtë qëllim, menaxhmenti mban përgjegjësinë për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe raportimin mbi shkallën e realizimit të objektivave, ndërsa Bordi i Drejtorëve ushtron përgjegjësitë e tij për drejtim strategjik dhe mbikëqyrje, në përputhje me kompetencat përkatëse.

Bordi i Drejtorëve vlerëson se ky plan përbën një bazë të rëndësishme për zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të ndërmarrjes. Megjithatë, suksesi i tij do të matet përmes rezultateve konkrete, përmbushjes së objektivave të përcaktuara dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve të transportit publik për qytetarët e Prishtinës.

Me zbatimin e përgjegjshëm të këtij plani, "Trafiku Urban" synon të forcojë rolin e tij në zhvillimin e transportit publik dhe të kontribuojë në krijimin e një qyteti më të qasshëm, më efikas dhe më të qëndrueshëm.

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE • MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE
N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. PRISHTINË

Urim Seferi

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
N.P.K. "Trafiku Urban" Sh.A.